

Nr. 3034 prc t.

24.11.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

AMENDAMENT I DEPUTETIT

TITULLI I AMENDAMENTIT: RITJA E PAGAVE TË MESUESËVE NË TABELËN
NR. 1 TË BUXHETIT NË KODIN 11/09120 DHE NË KODIN 11/09230.

KËRKUES:

Znj. Monika Kryemadhi

Deputet i Kuvendit të Shqipërisë

OBJEKTI:

“PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN
PËR BUXHETIN E VITIT 2022”

BAZA LIGJORE:

Neni 75 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë

ARGUMENTIMI I PROPOZIMIT:

Në vitet e fundit Shqipëria po kalon nga njëra krizë në tjetrën, ku mbi të gjitha kriza e besimit ndaj institucioneve dhe ajo financiare po detyrojnë qytetarët të largohen çdo ditë. Ky fenomen më së shumti ndjehet në shkollat dhe universitetet tona, ku numri i nxënësve dhe studentevë ulet në mënyrë të përvitshme. Shkolla të arsimit parauniversitar mbyllen çdo vit e njëkohësisht çdo vit mbyllen degë në universitete duke krijuar edhe mungesa të rëndësishme në tregun e punës. Sektori i arsimit është një ndër sektorët më të nënvlerësuar, pa investim dhe pa vizion serioz. Kur krahasohen buxhetet, pagat e programet e Shqipërisë me vende të tjera të rajonit, ne vazhdimisht jemi në vendin e fundit. Ndaj po paraqesim këto amendime që rrisin buxhetin e arsimit parauniversitar dhe arsimit të lartë, me synim kthimin e arsimit në prioritet kombëtar dhe investimin në burimet njerëzore që përbëjnë edhe shtyllën e shoqërisë shqiptare.

Rritja prej vetëm 6% e pagës së mësuesve të arsimit parauniversitar është e pamjaftueshme duke marrë në konsideratë rritjen e cmimeve në përgjithësi, ndaj në zërin shpenzime korente për arsimin bazë dhe arsimin e mesëm shtohen gjithësej 2 miliard lekë, respektivisht 1,4 miliard për arsimin bazë dhe 600 milion lek për arsimin e mesëm, me qëllim rritjen e pagës së mësuesve dhe financimin e programeve të përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvénit të Shqipërisë, ku specifikohet se: *“Çdo deputet ose Këshilli i Ministrave ka të drejtë të paraqësë në seancë plenare amendamente për projektligjin ose ndryshimet e propozuara nga komisioni përgjegjës, me kusht që ato të jenë të regjistruara paraprakisht në sekretari të paktën 24 orë para fillimit të seancës plenare dhe t’u jenë shpërndarë deputetëve të tjerë”*, parqes amendamentin sipas Aneksit 1 bashkëlidhur. Ky amendament do të prezantohet nga një deputet.

Duke e vlerësuar shumë të rëndësishme zhvillimin e bujqësisë, si dhe duke e vlerësuar si thelbësore për ruajtjen e marrëdhënies së besimit midis shtetit dhe qytetarëve, duke përfshirë edhe përgjegjshmërinë e Qeverisë në mbajtjen e premtimeve elektorale, propozoj miratimin e këtij amendamenti në seancë plenare.

MONIKA KRYEMADHI



ANEKSI 1

Në projektligjin për buxhetin e vitit 2022 të bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

Neni 1

Në Nenin 1 të shtohet pika: “Për buxhetin e vitit 2022 të RRITEN PAGAT E MESUESËVE NË TABELËN NR. 1 TË BUXHETIT NË KODIN 11/09120 DHE NË KODIN 11/09230.